

Prof. Asoc. Dr. Enriketa KAMBO

FILLIMET E ARSIMIT TË LARTË DHE HAPJA E UNIVERSITETIT TË TIRANËS (1946-1960)

Ndryshimet ekonomiko-shoqërore dhe arsimore të pasluftës kushtëzuan edhe zhvillimet në arsimin e lartë shqiptar. Dihet se ai përfaqëson majën e piramidës të çdo sistemi arsimor, një hallkë tejet të rëndësishme, nga ecuria dhe rezultatet e së cilës mund të gjykohet për shkallën e progresit të të gjithë shoqërisë. Deri në fillim të Luftës II Botërore specialistët e lartë shqiptarë u përgatitën kryesisht në universitetet e vendeve të tjera perëndimore. Niveli i trashëguar, vështirësitë e rritjes dhe sidomos orientimi i ri politik përcaktuan veçoritë më kryesore të arsimit të lartë në vend. Shteti shqiptar iu përmbajt politikave të përgjithshme të zbatuara në shoqëritë e komanduara. Për udhëheqjen komuniste, arsimit të lartë përfaqësonte jo thjesht një mundësi më tepër për shkollimin e popullsisë, por “çelësin” e zgjidhjes së problemit të përgatitjes së kuadrit të nevojshëm e të përshtatshëm për zhvillimin socialist të ekonomisë e të kulturës. Procesi i krijimit dhe konsolidimit të arsimit të lartë kaloi nëpërmjet dy fazave që nga pikëpamja kohore, intensiteti i ndryshimeve dhe rezultatet dallojnë dukshëm nga njëra-tjetra.

Gjatë fazës së parë që u shtri deri në mesin e viteve 50 u hodhën themelet e shkollës së lartë. Instituti Pedagogjik 2-vjeçar i hapur më 20 dhjetor 1946 shënoi fillimet e kësaj kategorie arsimore. Sipas njoftimit të parë publik të bërë nga e përditshmja më e madhe e kohës “Bashkimi” në shtatorin e këtij viti, instituti do të ishte “një përpjekje shkencore e zhvilluar në mënyrë që për së afërmi” të mund të çonte në hapjen e “fakulteteve të para universitare”.¹ Një muaj më vonë ideja u konkretizua në vendimin e Këshillit të Ministrave për hapjen e institutit fillimisht me 3 fakultete dhe afate 2 vjeçare që më tej do të bëheshin 4-vjeçare.²

¹ “Bashkimi”, dt. 29.09.1946.

² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*) Fondi 890, viti 1946, dos. 10. (Vendim i K.M. Nr. 135, dt. 22.10.1946).

Në fjalën e mbajtur nga ministri i Arsimit Sejfulla Malëshova, iniciativa “e organizimit të shkollave të larta në Shqipëri” do të vlerësohej si veprim largpamës për sigurimin e specialistëve të lartë “në fushën e teknikës dhe të shkencës të domosdoshëm për realizimin e problemeve të mëdha ekonomike e sociale”.³ Sipas rregullores së hartuar pak më vonë, ai ishte “një shkollë studimesh të larta me karakter universitar në sistemin e rregullt të ditës dhe atë të korrespondencës që përgatiste mësues për shkollat unike të Republikës Popullore të Shqipërisë, në këto disiplina: Gjuhë e Letërsi Shqipe, Histori, Gjeografi, Shkenca Biologjike, Fizikë e Matematikë”.⁴

Vështirësitë ishin të mëdha për faktin se fillohej nga niveli zero. Asnjë nga 17 pedagogët e parë nuk kishin dhënë mësim universitar. Tekstet origjinale në gjuhën shqipe për shumicën e lëndëve mungonin. Studentët e ardhshëm kishin boshllëqe sepse pjesa më e madhe i rikthehej shkollës pas një ndërprerje të gjatë për shkak të luftës. Ndër 346 të regjistruarit e parë në vitin shkollor 1946-1947, vetëm 53 studentë të rregullt të ditës dhe 29 të korrespondencës arritën rezultate.⁵

Instituti Pedagogjik 2-vjeçar që në fillim punoi mbi bazën e një dokumentacioni të ri shkollor. Kriteret e përgjithshme që u zbatuan në hartimin e tij ishin të njëjta me ato të kategorive të tjera arsimore. Ai u bazua në planet e programet shkollore jugosllave e më vonë në ato sovjetike. Krahas lëndëve të specialitetit u futën lëndë politike dhe lëndë të përgjithshme të detyrueshme për secilën degë si: Filozofia M-L, Psikologjia, Pedagogjia e përgjithshme, Praktika pedagogjike dhe Gjuha e huaj. Për sistemin e ditës gjuha e huaj ishte rasishtja ose serbo-kroatishtja dhe për atë të korrespondencës një nga gjuhët e mëdha perëndimore.⁶

Në vitin shkollor 1949-1950 u bë një riorganizim degësh dhe u shtuan disa degë të reja. Instituti Pedagogjik përgatiste tashmë mësues në specialitetet gjuhë-letërsi, histori, gjeografi, shkenca biologjike - kimi, fizikë-matematikë dhe gjuhë ruse.⁷ Ndërkohë u morën masa për sigurimin e kuadrove më të kualifikuara, pajisjen me një bazë materiale qoftë edhe të thjeshtë, u rritën kërkesat për pranimin vetëm të elementëve që kishin përfunduar gjimnazin ose shkollat pedagogjike dhe u shtuan mjetet financiare.

Në fillimin e viteve 50 vendi hyri në rrugën e planifikimeve afatgjata. Shteti komunist që synonte një industrializim të shpejtë, ndërmori një kuadër masash për orientimin e veprimtarisë së shkollave të larta dhe të

³ “Bashkimi”, dt. 21.12.1946.

⁴ *AQSh*, Fondi 1011, viti 1947, dos. 33, fl.1-10.

⁵ *Po aty*.

⁶ *Rregullore e Përgjithshme e Institutit Pedagogjik të Tiranës*, Tiranë 1947, f.12.

⁷ *AQSh*, Fondi 1011, viti 1949, dos. 26, fl.2-3.

institucioneve shkencore drejt zgjidhjes së problemeve që shtronte ekonomia socialiste. Kjo çoi në përshpejtimin e ritmeve të zgjerimit të të gjithë sistemit arsimor shqiptar. Në vitin 1951 u hapën tre institute të reja, Instituti i Lartë Pedagogjik 4-vjeçar, Instituti i Lartë Bujqësor dhe Instituti i Lartë Politeknik.⁸ Instituti Pedagogjik 4-vjeçar ashtu si edhe ai 2-vjeçar përgatishnin mësues në pesë disiplina. Në përgjigje të nevojave për mësues të arsimit 7-vjeçar, dy nga profilet u riorganizuan. Fakulteti Histori-Gjeografi u zëvendësua me atë të Historisë me elemente të Gjuhës Shqipe dhe ai i Biologji-Kimisë me Biologji-Gjeografi. Instituti Politeknik fillimisht kishte tri degë, Ndërtim, Elektrike dhe Mekanike edhe po aq edhe Instituti Bujqësor, degët Agronomi, Zooteknikë dhe Veterinari.⁹ Hapja e instituteve të reja çoi në uljen e numrit të specialistëve që përgatiteshin jashtë, kryesisht në BS dhe në vendet e tjera të Lindjes. Deri në vitin 1950 në këto shkolla mësuan rreth 767 studentë.¹⁰

Për zhvillimin e shpejtë të arsimit të lartë u përballuan vështirësi të njëjta si për të gjitha hallkat e tjera të sistemit arsimor, por edhe probleme specifike. Pajisjet e nevojshme laboratorike dhe kabinetet mësimore kishin mungesa. Dokumentacioni shkollor ishte i pamjaftueshëm dhe me mangësi në profile e specialitete. Tekstet dhe dispencat e përkthyer ishin të vështira në përdorim. Me gjithë përpjekjet që shkollat e larta të punonin të paktën me tekstet bazë, problemet për vite me radhë vijuan. “Studentët, do të thuhej në një nga dokumentet e kohës, nuk kanë tekste. Profesorët... përgatiten duke përdorur libra dhe botime të ndryshme dhe studentët përgatiten me shënimet që marrin në klasë”.¹¹

Për aq sa ishin nevojat e para për kuadro, nga pikëpamja sasiore ato u plotësuan si me studentët që kishin përfunduar universitetin në Perëndim ashtu edhe me ato të përgatitur në shkollat e larta të vendeve lindore. Drejtuesit dhe pedagogët e parë të shkollave të larta ishin autoritete të njohura por edhe emra, që gradualisht u formuan si personalitete të fuqishme të arsimit dhe të shkencës shqiptare si Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Eqrem Çabej, Dhimitër S. Shuteriqi, Aleks Buda, Sotir Angjeli, Kol Paparisto, Fejzi Hoxha etj. Çështja e mprehtë e viteve të para ishte ajo e mungesës së përvojës dhe dobësitë metodike të kuadrit sidomos atij të ri. Si do të pohohet në një informacion të Institutit të Lartë Pedagogjik 2 dhe 4-vjeçar duke bërë fjalë për vitin shkollor 1951-1952, “kemi pasur 10 pedagogë efektivë të rinj, që japin për herë të parë mësim në një institut të

⁸ *Po ary*, Fondi 890, viti 1951, dos. 445, fl.6. (Vendim i K.M. Nr. 548, dt. 27.07.1951).

⁹ *Po ary*, Fondi 1011, dos. 27, fl. 2.

¹⁰ *Po ary*, viti 1950, dos. 26, fl.22.

¹¹ *Po ary*, viti 1952, dos. 19, fl.99.

lartë. Këta sigurisht kanë përgatitje të mirë, do të vijojej, por këtyre iu mungon përgatitje metodike, iu mungon eksperiencia...¹² Po kështu, “Në procesin mësimor dhe sidomos në metodikën e mësimit, do të thuhej në një tjetër dokument të kohës, ka shumë të meta... kështu psh. shumë profesorë lexojnë leksione pa iu treguar studentëve... materiale ilustrative... gjuha e leksioneve akoma është e varfër... Në seminare janë përdorur metodat e shkollës së mesme me pyetje dhe përgjigje, gjë që ka prerë iniciativën e studentëve për të diskutuar”.¹³

Dobësitë që u pasqyruan në nivelin e dobët ideo-shkencor të lëndëve të zhvilluara dhe natyrisht edhe në shkallën e përgatitjes së studentëve lanë gjurmët e veta në vetë cilësinë e shkollave të larta. Në kushtet kur arsimi i lartë sapo ishte krijuar, vëmendja u përqëndrua më tepër në zgjerimin dhe forcimin e strukturave organizative se sa në cilësinë e punës mësimore edukative. Kjo ishte një nga dukuritë më tipike të ecurisë së shkollës shqiptare në dhjetëvjeçarët e parë të pasluftës.

Shkolla e lartë si pjesë integrale e gjithë sistemit arsimor u zhvillua që në fillimet e saj si një shkollë e re e orientuar. Në bazë të Kushtetutës së RPSH të vitit 1946, të drejtën e arsimit të lartë e kishin “të gjithë” shtetasit. Statuti i parë i vitit 1951 përcaktonte se shkollat e larta ishin institucionet që realizonin “përgatitjen e specialistëve me kualifikim të lartë për degët kryesore të prodhimit”, të aftë “për të përvetësuar shkencën dhe teknikën përparimtare, të pajisur me njohuritë e socializmit shkencor, të gatshëm të mbrojnë atdheun”.¹⁴

Detyrimet që rridhnin sipas statutit përmblihdeshin në organizimin e procesit mësimor të rregullt, hartimin e teksteve të përgjithshme dhe origjinale, zhvillimin dhe fuqizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore etj. Gjithnjë sipas tij, të drejtën për të mësuar në shkollat e larta e gëzonin të gjithë ata që kishin diplomën e pjekurisë. Por në përzgjedhjen e studentëve shteti iu përmbajt me rigozitetin parimit të përkatësisë politike dhe klasore. Shumica e elementëve të etiketuar si jo shumë “të pastër” politikisht apo si “të deklasuar”, nuk pati mundësinë për të studiuar në shkollat e larta, duke iu mohuar një e drejtë demokratike e ligjshme për çdo individ.

Përgatitja e inteligjencies së re domosdoshmërisht nga klasa punëtore apo fshatarësia, i kthyer thujt në një “obsesion” për drejtuesit e vendit, përcaktoi edhe politikat e ndjekura në këtë fushë. Për të njohur dimensionet reale të procesit të filluar në këto vite dhe të thelluar në vijimësi, po e ilustruam me disa dokumente të kohës. Sipas një vendimi të brendshëm të

¹² *Po aty*, fl.69.

¹³ *Po aty*.

¹⁴ *Po aty*, viti 1951, dos. 32, fl.28.

Sekretariatit të KQ të PPSH të vitit 1951, rishqyrtimi i herëpashershëm i listave nga ana e organeve shtetërore dhe ato partiake, duhej të shmangte përfshirjen e “elementëve të këqinj” dhe në rastet kur ishte bërë ndonjë gabim, të zëvendësoheshin me ato që janë sot në prodhim dhe janë “të mirë”. Qëndrimi i vendosur për të mos rrezikuar pastërtinë e inteligjencës së ardhshme nuk fshihet. “Është një gabim i madh, thuhej shprehimisht po në këtë vendim, që të dërgohen në Universitet njerëz të borgjezisë, të cilët pas 4 vjetësh nuk mund t’i besojmë për t’i vendosur në punë si inxhinierë etj”.¹⁵

Në përputhje me kushtet e kohës ku nevojat për specialistë ishin tepër të mëdha, *institutet e larta funksionuan mbi bazën e profilit të përgjithshëm*. Kjo do të thoshte se pas përfundimit të shkollës kuadrot e larta do të mund të punonin në profesionin e tyre, por edhe në fusha të përfaqëta. Në vitin 1952 rrjeti i shkollave të larta u zgjerua me dy institute të tjera, Institutin Ekonomik dhe Institutin Mjekësor.¹⁶ Po në këtë vit, pranë Instituteve Politeknik, Bujqësor dhe Pedagogjik 4-vjeçar u hap sistemi i korrespondencës, për secilin fakultet me afate 5-vjeçare. Studentët që i përfundonin qusheshin specialistë të lartë. Në vitin shkollor 1952-1953, në të gjitha shkollat e larta brenda dhe jashtë vendit mësonin rreth 530 studentë.¹⁷

Procesi i zgjerimit dhe organizimit më të mirë të shkollave të larta ndihmoi në zbutjen disi të problemit të kuadrit. Por nevojat e ekonomisë vijuan të ishin të mëdha dhe rrjeti i institucioneve nuk i përballonte dhe nuk i përgjigjej kërkesave për specialistë të fushave të ndryshme. Në këtë fazë të parë u tendua edhe për hapjen e degëve me specialitet të ngushtë. Por ato u gjykuan të papërshtatshme për natyrën e ekonomisë shqiptare. Përgatitja e specialistëve të përgjithshëm ishte dhe mbeti një politikë e vazhdueshme e shtetit shqiptar për disa dhjetëvjeçarë e kushtëzuar si nga niveli i trashëguar dhe vështirësitë e rritjes ashtu edhe nga modeli i përdorur.

Për sigurimin e studentëve të fakulteteve sidomos atyre më të vështira apo më pak të preferuara, u përdor gjerësisht sistemi i bursave. Rëndësi u dha sidomos përgatitjes së specialistëve në fushat ku nevojat ishin më të mëdha. Investimet erdhën në rritje. Po e ilustrjmë me një shembull. Në totalin e shpenzimeve sipas buxhetit të Ministrisë së Arsimit për vitin 1954 prej 83. 714. 000 lekë, bursat dhe specializimet kapin shumën e 34. 102. 000 lekë. E krahasuar me atë të një viti paraardhës ka një rritje prej rreth 49,34 për qind.¹⁸

¹⁵ Po aty, dos. 23, fl.3. (Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH, nr. 871, dt. 5.10.1951).

¹⁶ Po aty, Fondi 1011, dos. 10. (Vendim i K.M., Nr. 381, dt. 7/06/1952).

¹⁷ Po aty, dos. 22, fl.3. (Vendim i K.M., Nr. 815, dt. 20/12/1952).

¹⁸ Po aty, viti 1954, dos. 48, fl.24.

Si përparësi e periudhës u trajtua plotësimi i numrit të studentëve në Institutin Bujqësor dhe në Institutin Politeknik që përgatitsnin specialistë të bujqësisë dhe të industrisë. Fenomeni i regjistrimeve “të programuara” i kthyer thuhet në një ritual të përvitshëm, evidencohet lehtësisht në shumë nga udhëzimet rutinë të periudhës. Vetë Këshilli i Ministrave në korrespondencat me organet e tij vartëse kërkon në mënyrë të përsëritur që “në shpërndarjen e nxënësve të mbahet parasysh që Instituti Bujqësor, të plotësohet para të tjerëve”.¹⁹ Kuptohet që regjistrimi i detyrueshëm çonte në largimin e shumë studentëve pa përfunduar shkollën dhe për rrjedhojë edhe në uljen e numrit të specialistëve të lartë.

Duke filluar nga viti shkollor 1955-1956 u morën në vijimësi masa të reja që synuan forcimin e shkollave të larta. Në Institutin Politeknik afati i studimeve u rrit nga 4 në 5 vjet. Instituti i Lartë Bujqësor u pasurua me degë të reja dhe u forcuan deri-diku kërkesat për pranimin e studentëve me rezultate më të mira. Në Fakultetin e Shkencave në masën kryesore pranohen gjimnazistë me rezultate më të mira në lëndët e shkencave natyrore etj.²⁰ Me përpjekjet e bëra u përmirësua baza materiale dhe didaktike. Shumë fakultete u pajisën me laboratorë. Shumica e pedagogëve që më parë punonin në shkollat e mesme, me kalimin e viteve fituan përvojën e punës në shkollat e larta.

Kuadro të reja, njerëz me vullnet dhe dashuri për arsimin përgatitën plane e programe mësimore, përkthyer dhe hartuan tekstet e nevojshme për degët e reja. Pjesë e rëndësishme e procesit ishin edhe zhvillimet në fushën e përgatitjes dhe të specializimit të personelit mësimor. Me vendim të Këshillit të Ministrave, në majin e vitit 1955 u fut sistemi i aspiraturës, në shkollat e larta dhe institucionet kërkimore shkencore. Ky sistem natyrisht ishte i njëjtë me atë të zbatuar nga vendet e tjera të lindjes. Ai u jepte mundësi pedagogëve të kualifikoheshin më tej dhe të fitonin gradat shkencore “Kandidat i Shkencave” dhe “Doktor i Shkencave”.²¹ Sipas vendimit aspiratura organizohej nëpërmjet dy formave, me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna, duke i dhënë prioritet kësaj të fundit. Kjo nënkuptonte që për një farë kohe përgatitja do të realizohej në masën kryesore brenda vendit. Për organizimin e sistemit të aspiraturës, po në majin e këtij viti, u krijua Komisioni i Lartë i Atestimit, si organ kordinues i gjithë veprimtarisë në shkallë vendi.²² Me zbatimin që nga viti 1956 i sistemit të ri të kualifikimit, u rritën mundësitë edhe për një punë më cilësore në shkollat e

¹⁹ *Po aty*, viti 1953, dos. 32, fl.1-2.

²⁰ *Po aty*, Fondi 890, viti 1956, dos. 777, fl.36. (Vendim i K.M., Nr. 37, dt. 7/09/1956.

²¹ “Gazeta Zyrtare”, viti 1955, nr. 7, dt. 7/06/1955. (Vendim i K.M., Nr. 153, dt. 2/05/1955).

²² *Po aty*.

larta. Në vitin shkollor 1955-1956, sistemi i arsimit të lartë në vend përfshinte 6 institute 4 dhe 5-vjeçare me 22 fakultete dhe rreth 1595 studentë.²³

*
* *
*

Universiteti i parë shqiptar

Mesi i viteve 50 duket se shënoi një moment tejet të rëndësishëm në procesin e kalimit nga faza e hedhjes së bazave të shkollës së lartë në atë të përqëndrimit të gjithë veprimtarisë në një qendër drejtuese dhe orientuese në shkallë vendi. Zhvillimet në aspektin sasior përgatitën terrenin për thellimin e procesit dhe padyshim ndikuan në zbutjen e kërkesave për kuadro. Por veprimtaria e shkëputur e shkollave të larta, dora dorës po shndërrohej në një fazë të kapërcyer, madje e tejzgjatur ajo rrezikonte të dëmtonte ritmet e procesit. Që kalimi drejt Universitetit ishte një domosdoshmëri, tashmë nuk mund të vihej më në dyshim. Ky kalim për të cilin ishin të interesuar si shteti ashtu edhe individi, u favorizua nga disa faktorë që gjithsesi çuan në zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të arsimit të lartë.

Para së gjithash, nga pikëpamja e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik e shoqëror, kishin ndodhur ndryshime të rëndësishme. Shteti ishte fuqizuar dhe ambicia e tij për industrializimin e shpejtë ishte rritur. Në këto kushte kalimi drejt një forme më të lartë dhe më të zhvilluar organizimi siç ishte Universiteti, vlerësohej si një mundësi më e gjerë që ushqente me tej prirjen e zgjerimit të profileve dhe nevojën e hapjes së fakulteteve të reja.

Investimet dhe niveli i shpenzimeve për frymë të popullsisë në fushën e arsimit dhe të kulturës, të marra qoftë edhe me rezerva, ishin rritur. Nga 48 milion lekë (sipas kursit të atëhershëm) në vitin 1950, në vitin 1960-1961 arritën në 154 milionë lekë.²⁴ Për masivizimin e arsimit të lartë u thelluan gjithashtu masat me karakter social. Deri në këto vite dhe më tej studentët nuk paguanin taksa. Rreth 60 për qind studionin me bursa shtetërore dhe në degë e specialitete ku nevojat ishin më të mëdha deri në 80 për qind e tyre. Ndërkohë subvencionoheshin gjithnjë nga shteti mensat, shtëpitë e

²³ AQS, Fondi 1011, viti 1951, dos. 8. (Të dhënat mbi realizimin e pesëvjeçarit i përkasin vitit 1956).

²⁴ "40 vjet Shqipëri Socialiste", Tiranë 1984, f.139.

studentëve, bibliotekat, praktikat mësimore dhe tekstet bliheshin nga studentët nën koston reale të botimit.²⁵

Faktorë të tjerë ishin si zhvillimet e reja brenda sistemit arsimor në përgjithësi ashtu edhe ato në vetë arsimin e lartë në veçanti. Pas kalimit në vitin 1952 nga arsimi fillor në arsimin 7-vjeçar të detyruar dhe zgjerimin e arsimit të mesëm, sidomos atij profesional u rrit sasia e nxënësve që mund të vijonin shkollat e larta. Për rrjedhojë këto shkolla u përballën me një vërshim të vërtetë. Nga 304 studentë që studionin në vitin shkollor 1950-1951, në prag të hapjes së Universitetit numri i tyre pothuajse u dhjetëfishua duke arritur në shifrën e 3 411 studentëve.²⁶

Në këto kushte ishte e dukshme që mundësitë për krijimin e Universitetit ekzistonin. Problemi qëndronte në organizimin dhe institucionalizimin e tij dhe më tej në konsolidimin dhe shndërrimin në një qendër të vetme me kontribut të pazëvendësueshëm për përgatitjen e specialistëve të nevojshëm për zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit. Çështja, nëse momenti për të ndërmarrë një hap të tillë ishte i përshtatshëm, u bë objekt studimi dhe diskutimi nga intelektualë dhe organizma shtetërore e partiake që nga fillimi i vitit 1956. Mendimet e shfaqura ishin nga më të ndryshmet. Shumica i quanin të pjekura kushtet për krijimin e Universitetit. Më të tërhequr ishin një pjesë e drejtuesve të Instituteve të Larta dhe të dikastereve që drejtonin. Rezervat u shprehën lidhur me dallimet që kishte në afatet, nivelin dhe destinacionin e specialistëve të përgatitur. Gjithnjë sipas tyre, “Universiteti përgatit kadro teknike e shkencore me afat 5-vjeçar, ... kurse Institutet përgatitin specialistë për prodhim, rregullisht me afate 4-vjeçare”.²⁷ Dallimet pranoheshin nga specialistët e arsimit, por për pjesën më të madhe të tyre, “Përgatitja e kadrit shkencor dhe për prodhim, ashtu si dhe afati i studimeve mvaret e përcaktohet nga plani mësimor, pra janë çështje të brendshme të jetës së Universitetit, që mund të rregullohen”.²⁸

Ndër argumentet e sjella në mbështetje të idesë për krijimin e Universitetit, përveç rëndësisë politike, Ministria e Arsimit parashikonte atë të krijimit të hapësirave më të mëdha për kualifikimin e pedagogëve, hedhjen e bazave për aspiraturën në vend, ekonomizimin e personelit mësimor dhe administrativ, forcimin dhe shfrytëzimin me kapacitet të plotë të bazës materiale dhe didaktike etj.

Duket se diskutimeve iu dha fund një vendim i Byrosë Politike të korrikut 1956, për ngritjen e Universitetit Shtetëror në Tiranë në shtatorin e

²⁵ B. Golemi - V. Misja, *Zhvillimi i arsimit të lartë në Shqipëri*, Tiranë 1987, f.47.

²⁶ *Vjetari Statistikor i RPSH*, Tiranë 1965, f.357.

²⁷ *AQSh*, Fondi 1011, viti 1956, dos. 22, fl.11-12. (Studim i M. Arsimit dt. 24/3/1956).

²⁸ *Po aty*.

vitet 1957, përgatitjen e kuadrit ligjor të nevojshëm si edhe të kushteve paraprake për këtë qëllim.²⁹ Në vendimin e mëvonshëm të po kësaj strukture të lartë partiake në majin e vitit 1957, do të përcaktoheshin në detaje fakultetet që do të krijoheshin, planet mësimore të ndërtuara sipas profilit universitar, destinacioni kryesor i specialistëve që do të përgatiteshin, institutet e larta që do të përfshiheshin, kushtet që do të garantonin kualifikimin e pedagogëve etj. Synimi ishte që “Universiteti të bëhej qendra kryesore arsimore dhe shkencore e vendit”.³⁰

Në 3 qershor 1957, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë dekretoi një nga ligjet më të rëndësishëm në fushën e arsimit. Neni 1 i dekretit përcaktonte: “Krijohet në Tiranë Universiteti Shtetëror. Në këtë Universitet shkrihen Instituti Pedagogjik, Politeknik, Ekonomik, i Mjekësisë, Juridiku dhe Instituti i Shkencave”.³¹ Sipas Dekretit institucioni i emërtuar “Universiteti Shtetëror i Tiranës” vihej në vartësinë e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, viti i parë akademik i të cilit do të fillonte më 1 shtator 1957. Këshilli i Ministrave, mbështetur në këtë dekret, nxori vendimin sipas të cilit, Universiteti fillimisht do të kishte 6 fakultete: Fakultetin Histori-Filologji me degët e Historisë dhe atë të Filologjisë, Fakultetin Juridik, Fakultetin Ekonomik me degët e Ekonomisë dhe atë të Kontabilitetit, Fakultetin e Inxhinierisë me 4 degë: Mekanike, Elektrike, Ndërtim dhe Gjeologji, Fakultetin e Shkencave të Natyrës me degët: Matematikë-Fizikë dhe Biologji-Kimi dhe Fakultetin e Mjekësisë. Ai do të përgatiste specialistë në rreth 15 fusha dhe do të kishte rreth 46 katedra.³²

Në momentet e para të funksionimit Universiteti do të përdorte ish ndërtesat e shkollave të larta. Puna do të niste me një personel mësimor dhe administrativ prej 125 vetësh që do të rritej me përfshirjen graduale të specialistëve më të kualifikuar në vend dhe sjelljen e 24 kuadrove nga BS. Për përmirësimin dhe forcimin e bazës laboratorike parashikohej një shtesë prej 5. 152. 000 lekë në buxhetin e shtetit etj.³³ Universiteti nuk përfshinte Institutin Bujqësor, Zooteknik dhe Hidrometeorologjik, si dhe Institutin Pedagogjik dyvjeçar. Instituti i Gjuhësisë dhe Historisë, ish- pjesë e Institutit

²⁹ *Po aty*, dos. 26, fl.7. (Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH, Nr. 23/1, dt. 16/07/1956. “Mbi disa probleme të arsimit popullor”).

³⁰ *Po aty*, viti 1957, dos. 4, fl.1. (Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH, Nr. 162, dt. 15/05/1957).

³¹ “Gazeta Zyrtare”, viti 1957, Nr. 9, dt. 10/8/1957, f.306. (Dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH, Nr. 207, dt. 3/06/1957).

³² “Zëri i Popullit”, dt. 13/06/1957, f.3.

³³ *AQSh*, Fondi 1011, viti 1956, dos. 31, fl.35-36. (Vendim i K.M. të RPSH, Nr. 197, dt. 25/05/1957).

të Shkencave, hyri në përbërjen e Universitetit duke funksionuar pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë.

Në korrikun e vitit 1957 u përgatit edhe statuti i parë i Universitetit. E drejta e arsimit të lartë, u shpall si një e drejtë që u takonte të gjithë shtetasve “pavarësisht nga kombësia, raca seksi dhe gjendja ekonomike e shoqërore”.³⁴

Jeta e brendshme e Universitetit Shtetëror të Tiranës do të funksiononte mbi bazën e rregullores së përgjithshme të aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe ajo e fakulteteve me rregulloret e tyre të brendshme. Pozicioni i instituteve kërkimore shkencore dhe i punës shkencore përcaktohej në nenin 34 të statutit. “Instituti i kërkimeve shkencore, gjithnjë sipas tij, është një institucion shkencor organizativ i Universitetit, që zhvillon një veprimtari kërkimesh shkencore në një ose disa degë të dijeve shkencore dhe varet nga fakulteti i specialitetit përkatës”.³⁵

Vendimi i hapjes së Universitetit u bë publik në mitingun e organizuar në Tiranë më 10 qershor 1957. Rektori i parë Zija Këlliçi e përcaktoi si një nga institucionet më të rëndësishëm shkollorë që do të siguronte “përgatitjen e specialistëve të lartë për zhvillimin e ekonomisë popullore, kulturës, shërbimit mjekësor si dhe për zhvillimin e shkencës në të gjitha fushat e diturisë”.³⁶ Për intelektualin e njohur Prof. dr. Aleksandër Xhuvani ngritja e Universitetit hapte perspektiva zhvillimi dhe njëherësh përmbushte dëshirat “më të dashura të patriotëve tonë, që menduan dhe punuan për një Shqipni të lirë e të përparueme...”, realizonte vizionin e mendimtarit të shquar të Rilindjes Kombëtare Sami Frashëri, që e përfytyronte “Shqipërinë e lirë të ardhshme me shkolla të nalta e me një universitet në kryeqytet, me një “gjithmësojtore”, si do ta quante ai”.³⁷

Universiteti Shtetëror i Tiranës hapi dyert më 16 shtator 1957. Krijimi i Universitetit ishte padyshim rrjedhojë e veprimit të shtetit por njëheri dhe i përpjekjeve të deriatëhershme të të gjitha forcave intelektuale. Ato ishin plotësisht të vetëdijshme se mbarëvajtja e tij ishte përgjegjësi dhe detyrim serioz për përgatitjen e një gjenerate të re intelektualësh që do t’i shërbenin vendit. Me hapjen e universitetit nisnin zhvillime të reja brenda arsimit të lartë shqiptar, duke e futur në fazën e konsolidimit të mëtejshëm dhe të përbaljes me sfidat e shumta të së ardhmes. Në këtë rrugë Universitetit të Tiranës iu desh të gjente zgjidhjet e përshtatshme për probleme të vjetra dhe të reja.

³⁴ “Gazeta Zyrtare”, viti 1957, Nr. 9, f.313-314, dt.10/08/1957. (Vendim i K.M. të RPSH, Nr. 256, dt. 3/07/1957 “Mbi aprovimin e Statutit të USHT).

³⁵ Po aty.

³⁶ “Zëri i Popullit”, dt. 13/06/1957.

³⁷ Po aty.

Zhvillimet brenda arsimit të lartë tashmë ofronin të tjera mundësi për arsimimin e popullsisë. Por edhe pse premtuese arritjet ishin të pamjaftueshme në kushtet kur shkollat e larta gjithnjë e më tepër po shndërroheshin në institucione të preferuara për rininë. Përthithja e sasisë në rritje të të rinjve që synonin universitetin dhe përballimi i fluksit të tyre ishte një nga problemet e vështira e të ndërlikuara që duhej të gjente zgjidhje më të mirë. Që në fillim u tentua para së gjithash për zbutjen disi të shpërpjestimeve dhe përmirësimin e raporteve në numrin e studentëve nga fshati dhe atyre nga qyteti, midis djemve dhe vajzave, nga rajone të zhvilluara dhe ato më të prapambetura. Me gjithë përpjekjet, diferencat e krijuara ishin një dukuri në rritje. Ishte fakt që shumica e studentëve ishin nga qyteti dhe më pak nga fshati apo zonat periferike. Për ta ilustruar këtë po sjellim një informacion të Fakultetit të Mjekësisë, një nga më të preferuarit e kohës. “Këta studentë vijnë nga viset e ndryshme të atdheut. Por ajo që bie në sy, vijojej në të, është se nga Kukësi, Peshkopia e Dibra ka fare pak studenta”.³⁸ Në vitet e para të funksionimit të Universitetit e ulët mbetej edhe pjesëmarrja e vajzave.

Përmirësimi i raporteve në vetvete ishte një fenomen progresiv dhe në një farë mënyre një investim me rrjedhoja pozitive për rritjen e nivelit të shkollimit të popullsisë, që çonte detyrimisht në normalizimin e gjendjes së arsimit në shkallë vendi. Shteti sigurisht e shihte problemin nga këndvështrimi i tij. Nga tërheqja në auditorët e Universitetit e sa më shumë studentëve dhe nga të gjitha rajonet, varej zgjidhja e çështjes aq të rëndësishme për një ekonomi të centralizuar, ajo e specialistëve të mjaftueshëm për të gjitha fushat, që garantonin zhvillimin e planifikuar dhe përpjestimor të kësaj ekonomie. Planifikimi socialist ishte mjeti i fuqishëm dhe mekanizmi kryesor në duart e shtetit totalitar që i mundësonte sigurimin e “përbërjes punëtore e fshatare të inteligjencies së re” dhe “zgjidhjen” e çështjes së papunësisë, duke hapur vende pune “për të gjithë”, nëpërmjet shpërndarjes së detyruar të specialistëve të lartë sipas degëve dhe rajoneve. Zgjerimin dhe fuqizimin e fakulteteve dhe specialiteteve shteti e vuri në funksion të plotësisht të nevojave të ekonomisë socialiste për kuadro. Sipas planifikimit të vitit 1958, nga rreth 1.300 nxënës që përfunduan shkollat e mesme u parashikua tërheqja në arsimin e lartë e 980 prej tyre.³⁹

Universiteti duhej t'i jepte rrugëzgjidhje të suksesshme përgatitjes së specialistëve për fushat më të rëndësishme duke plotësuar zbrazëtitë e ndjeshme për të tillë sektorë të përcaktuar strategjikë, si ai i naftës, gjeologjisë, transportit etj. Deri në fillimin e funksionimit të tij përgatitja më

³⁸ AQSht, Fondi 1011, viti 1954, dos. 29, fl.21-22.

³⁹ Po aty, Fondi 14, viti 1958, dos. 30.

e madhe e studentëve i përkiste fushave shoqërore. Peshat specifike e studentëve që ndiqnin fakultetet e inxhinierisë, bujqësisë, ekonomisë etj. zinte rreth 40 për qind të numrit të tyre të përgjithshëm.⁴⁰ Më tej raportet ndryshuan. Për rritjen dhe ruajtjen e numrit të studentëve, sidomos për degët e vështira dhe ato ku nevojat e ekonomisë ishin më të mëdha, u shtuan masat favorizuese nëpërmjet trajtimit me bursa të më tepër se 60 për qind të tyre.⁴¹

Politika e dhënies së bursave kuptohet që vazhdoi të mbetej e programuar dhe brenda të gjitha parametrave të mëparshëm ku kriteri kryesor ishte ai i përzgjedhjes mbi bazën e cilësive moralo-politike të kandidatit, nevojave të përcaktuara sipas degëve dhe në fund rezultateve në shkollën e mesme. Masat e këtyre viteve çuan në përmirësime të pjesëshme të strukturës sociale, rajonale dhe gjinore të studentëve. Bursat e ofruara u rritën nga 915 në vitin e parë të funksionimit të Universitetit, në 2.337 për vitin 1960-1961. Ngritje pësuan edhe treguesit që lidheshin me përmirësimin e kushteve të jetesës së studentëve dhe subvencionet e tjera.⁴² Pozicioni i vajzave evoluoi më ngadalë. Në gjithë arsimin e lartë ato zinin vetëm 19 për qind të studentëve. Nivele më të larta u shënuan në numrin absolut që ndryshoi nga 3.411 studentë në momentin e hapjes të Universitetit, në 6.703 gjatë vitit akademik 1960-1961.⁴³ Në këtë dinamikë, përpos faktorëve të tjerë, inpaktin më pozitiv e dha zgjerimi i arsimit të mesëm dhe shtimi i numrit të nxënësve që përfunduan këtë kategori shkollash. Sipas të dhënave zyrtare, deri në vitin 1959 Universiteti mundi t'i siguronte ekonomisë rreth 3.950 specialistë të lartë. Nevojat deri diku u zbutën, por çështja nuk mund të quhet e ezauruar për derisa edhe për disa vite, ai mundi të plotësonte vetëm 80,3 për qind të kërkesave që në vijimësi erdhën në rritje.⁴⁴

Duke qenë se në njëfarë mënyre i ishte dalë mbanë që të përshpejtoheshin ritmet, shanset për të futur në rrugën e zgjidhjes edhe të disa problemeve të tjera që kishte Universiteti, ndryshuan ndjeshëm. Prej kohësh shkolla shqiptare e të gjitha niveleve vuante pasojat e një cilësie të dobët të procesit mësimor-edukativ. Efekti më i pastër dhe më i dukshëm në arsimin e lartë ishte shkalla e pamjaftueshme e përgatitjes së specialistëve. Me kalimin e viteve ky problem aq kompleks e me spektër të gjerë veprimi ishte bërë më i mprehtë. Veprimet e ndërmarra rezultuan të pamjaftueshme. Stabilizimi i gjendjes kushtëzohet nga fokusimi më mirë i vëmendjes, shoqëruar kjo me masa që çonin në zgjidhje më të qëndrueshme. Asokohe pati një angazhim më serioz të shtetit, por edhe të gjitha forcave intelektuale

⁴⁰ B. Golemi - V. Misja, *Zhvillimi i arsimit të lartë në Shqipëri*, Tiranë, 1987, f.178.

⁴¹ *Po aty*, f. 56.

⁴² *Vjetari Statistikor i RPSH*, Tiranë, 1965, f.371-374.

⁴³ *Po aty*, f.357.

⁴⁴ *AQSh*, Fondi 1011, viti 1957, dos. 46, fl.3. (Material studimor i vitit 1959).

që punonin në fushën e shkollës. Kjo solli përmirësime disa prej të cilave edhe iluzive, por që gjithsesi i hapën rrugën ndryshimeve qoftë edhe të pjesshme.

Për shkaqe që janë analizuar shumica e studentëve, rreth 2/3 e tyre u tërhoqën nga shkollat profesionale. Më tej me shtimin e gjimnazeve prioriteti kaloi në përzgjedhjen e nxënësve të këtyre shkollave që dihet se kishin një përgatitje të përgjithshme shumë më të mirë. Kuadër më i plotë masash u ndërmor edhe për pasurimin e bazës materiale me laboratorë dhe kabinete të reja. Përmirësimet në plane, programe dhe tekste ndikuan gjithashtu pozitivisht. Ndryshimet synuan ngritjen e nivelit shkencor dhe pasqyrimin më të mirë të “realitetit shqiptar” i vlerësuar tashmë si “kryesor dhe vendimtar”,⁴⁵ për orientimin e specialistëve në problemet e ekonomisë dhe të kulturës. Kuadrot e përgatitura ndër vite, pavarësisht nga kufizimet ideologjike që iu nënshtuan të gjithë, dora dorës fituan fizionominë e një inteligjencie kombëtare që vuri të gjitha forcat dhe kapacitetin e saj intelektual në shërbim të progresit të shoqërisë shqiptare.

Të gjitha masat e viteve të para të funksionimit të Universitetit natyrisht kishin vlerën e tyre, por “Thembra e Akilit”, mbeti niveli i përgatitjes dhe i kualifikimit të personelit mësimor. Me zgjerimin e arsimit të lartë nevojat erdhën në rritje dhe brezi i pedagogëve të parë nuk mund t’i ndiqte më ritmet e shpejta. Hapja e fakulteteve dhe e degëve të reja i bëri kërkesat e papërbalueshme. Personelit ekzistues iu bashkangjit profesorati i ri i dalë nga përzgjedhja e asistentëve, kryesisht nga radhët e studentëve më të suksesshëm të fakulteteve shqiptare. Për të dhënë përmasat e procesit në këto pak vite jete të Universitetit po sjellim një të dhënë krahasuese. Nga 156 pedagogë në fillimet e tij, në vitin 1960-1961 kur laurohen universitarët e parë, ata gati dyfishohen duke arritur në 360.⁴⁶

Hapësira që krijuan zhvillimet në këtë fushë ndikuan në orientimin më të mirë ndaj çështjes së kualifikimit, që në kushtet e Universitetit mori një dimension të ri. Shqetësimi që përcillet në dokumentet e periudhës lidhej sidomos me shmangien e spontanitetit në zgjidhjen e tij. Brenda këtij koncepti masat u shumëfishuan. Drejtuesit, veçanërisht këshillat shkencorë të fakulteteve dhe instituteve u përqëndruan në përgatitjen dhe kualifikimin e pedagogëve më të rinj.⁴⁷ Diskutimi i leksioneve nga katedrat përkatëse, organizimi i informacioneve dhe seminareve shkencore, ndjekja e botimeve më të reja, përfshirja në sistemin e aspiraturës, ishin disa forma specifike që ndihmuan në formimin e përgjithshëm dhe atë profesional si dhe për futjen

⁴⁵ *Po aty*, viti 1959, dos. 7, f.38-39.

⁴⁶ *Anuari Statistikor i RPSH*, Tiranë, 1965, f.357.

⁴⁷ *AQSH*, Fondi 1011, viti 1960, dos. 53, f.31-32.

në rrugën e krijimit të individualitetit të tyre si specialistë të një dege të shkencës.

Profesorati i vjetër dhe i ri, që gjithnjë e më tepër po përballonte kërkesat në rritje për një proces mësimor të niveleve cilësisht të reja, kontribuoi njëheri edhe për studimin dhe zgjidhjen e problemeve të shkencës. Universiteti vazhdoi aktivitetin e nisur të disa institucioneve shkencore dhe të shkollave të larta. Forcat më të mira prej vitesh ishin vënë në funksion të fakulteteve duke dhënë leksione, hartuar studime, tekste mësimore etj. Shkollat e larta kishin një prodhimtari shkencore më të kufizuar dhe peshën më kryesore e mbante Instituti i Shkencave. Ai u përfshi në Universitet së bashku me institucionet ndihmëse si Muzeumi Etnografik, Arkeologjik, Biologjik, Gjeologjik, klinikat pranë fakultetit të Mjekësisë dhe Biblioteka Shkencore. Duke filluar nga viti 1957, revista “Buletini i Institutit të Shkencave”, kaloi si organ shkencor i Universitetit. Me ndryshimin e emërimit në “Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës”, revista u nda në dy seri: Seria e Shkencave Shoqërore dhe Seria e Shkencave Natyrore.⁴⁸

Vepri më i rëndësishëm shkencor e institucionalizuar tashmë në kuadrin e Universitetit ndikoi në përqëndrimin efikas të forcave mësimore dhe shkencore, sidomos të fushave më pak të lëvruara si ato natyrore dhe të aplikuara. Pranë fakulteteve u organizuan sektorë të rinj që hapën perspektiva për thellimin e studimeve. Në vitin 1960, pranë Fakultetit të Inxhinierisë u ngrit sektori i Hidroenergjitikës, ai i Gjeologjisë, Ndërtimit, Arkitekturës dhe në atë Ekonomik sektori i Shkencave Ekonomike etj.⁴⁹

Të ndodhur në fazën e studimeve fillestare, kontributi në fushën e shkencave natyrore përmbledhet kryesisht në përgatitjen e teksteve si edhe e studimeve më të thjeshta. Kërkimet në bujqësi dhe biologji u përqëndruan në mbledhjen dhe studimin e florës dhe faunës, njohjen e cilësive klimatike, të regjimit të lumenjve, studimin krahasues zonal të llojeve të bimëve bujqësore etj. Rezultate modeste do të ishin botimet “Drurët e shkurret e Shqipërisë” (Tiranë 1956) e Ilija Mitrushit; “Flora e Tiranës” (Tiranë 1960) përgatitur nga Kol Paparisto, Xhavit Qosja e Mustafa Demiri, tekstet universitare “Elementë të gjeomorfologjisë” (Tiranë 1959) nga Pandi Geço, “Tekst mbi gjeologjinë” (Tiranë 1959) dhe “Studime gjeologjike” (Tiranë 1960) nga Injac Ndojaj etj.

Në lëmin e studimeve mjekësore dhe veterinare u tentua kalimi nga faza e studimeve statistikore në ato me karakter klinik dhe eksperimental duke u përqëndruar në epidemologji, patologji dhe fiziologji, pediatri e mortalitetin

⁴⁸ “Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1957-1967”, Tiranë, 1967, f.123.

⁴⁹ AQSH, Fondi 1011, viti 1959, dos. 40, fl.17-18.

infantil, sëmundjet profesionale dhe ato bakteriologjike etj. Specialistë të njohur si Anton Ashta, Kadri Kërçiku, Hamdi Sulçebe, Fejzi Hoxha, Thoma Harito, Dhimitër Vavako e Zef Kakarriqi në më të shumtën e herës i botuan studimet e tyre në serinë e shkencave natyrore të Buletinit të Universitetit të Tiranës.⁵⁰

Studime të plota u realizuan në fushën e shkencave albanologjike ku dhe ishte krijuar një traditë. E gjithë tematika e punës së Institutit të Shkencave tashmë u bë pjesë e veprimtarisë shkencore të Universitetit. Në fushën e gjuhës shqiptare, studiues të veçantë por edhe ekipe të plota u morën me hartimin e gramatikës, të fjalorit shqip e disa fjalorëve dygjuhësh, përcaktimin e rregullave ortografike dhe të terminologjisë shkencore, në përpilimin e manualëve gjuhësorë të arsimit të lartë etj. Një veprimtari e frytshme u zhvillua në vazhdimin e studimeve mbi çështje që hidhnin dritë për një trajtim më shkencor e më të thelluar të morfologjisë dhe të sintaksës, duke sjellë risi të reja.⁵¹ Personalitete të gjuhësisë shqiptare si Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Dhimitër S. Shuteriqi, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Androkli Kostallari etj., sollën një kontribut që i shërbeu sqarimit të mjaft problemeve shkencore por edhe ngritjes së nivelit të leksioneve. Mund të përmenden tekstet “Leksikologjia dhe fonetika shqipe” dhe “Morfologjia e shqipes së sotme” (Tiranë 1957), hartuar nga Shaban Demiraj, “Gramatika e gjuhës shqipe” (Pj.II, Tiranë 1957), nga Mahir Domi, “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe”, Tiranë 1959, nga Eqrem Çabej, “Sintaksa e shqipes. pj.I Fjalja”, Tiranë 1959, nga Stefan Prifti etj. Kontribut me vlerë ishin përmbledhjet “Mbi pastërtinë e gjuhës shqipe” dhe “Çështje të gjuhësisë”, “Meshari” i Gjon Buzukut transkriptuar nga Eqrem Çabej, studimet mbi “Nyjet e shqipes” (1958) dhe Pronorët e shqipes” (1959), nga Selman Riza, “Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe” (1960) nga Eqrem Çabej etj.⁵²

Ndërmarrje e madhe në fushën e shkencave shoqërore do të ishte botimi i tekstit “Historia e Letërsisë Shqipe”, Tiranë 1959, përgatitur nga një kolektiv prej 16 autorësh. Në të ishin pasqyruar rezultatet e studimeve disa vjeçare të studiuesve dhe pedagogëve Dhimitër S. Shuteriqi, Zijaudin Kodra, Shaban Demiraj, Jup Kasttrati, Henrik Lacaj, Skënder Luarasi etj.

Kontribute të rëndësishme u sollën edhe në fushën e historiografisë. Studimi i problemeve madhore të historisë së popullit shqiptar nga periudhat më të hershme e deri në ato më të vonshme ishte tematika e preferuar e studiuesve të kësaj fushe. Mbi bazën e të dhënave historike, gjuhësore e

⁵⁰ “Buletini i shkencave natyrore”, Tiranë 1957, nr. 2, f.159-161.

⁵¹ M. Domi, “Realizimet dhe sukseset e gjuhësisë në RPSH në këto 15 vjet”. Buletini i UShT. Seria e shkencave shoqërore. Tiranë 1959, nr. 4, f.110-117.

⁵² “Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës”, Seria e shkencave shoqërore, viti 1959, nr. 4, f.110-118.

arkeologjike u hodh dritë mbi kontinuitetin e banimit të shqiptarëve dhe vazhdimësinë iliro-shqiptare. Rezultatet e ekspeditave arkeologjike dhe studimet e Hasan Cekës, Skënder Anamalit, Selim Islamit, Josif Andonit, Frano Prendit etj., ishin një kontribut në sqarimin e mjaft problemeve të historisë së lashtë. Studiues të njohur si Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Stefanaq Pollo, Zija Shkodra, Petraç Pepo etj., u thelluan në studimet e gjenezës së feudalizmit, problemit të formimit të shtetit feudal shqiptar, zhvillimit ekonomik e shoqëror gjatë periudhës osmane, mbi Rilindjen Kombëtare duke ardhur deri në kohët më të reja. Padyshim edhe në këtë fushë arritja më e rëndësishme ishte “Teksti i Historisë së Shqipërisë”, vëll. I, Tiranë, 1959 me autor Selim Islami dhe Kristo Frashëri.⁵³

Në fushën e folklorit dhe etnologjisë, të gjitha zonat e vendit u mbuluan nga ekspedita të shumta, kolektive dhe individuale për grumbullimin e materialeve të pasura të kulturës së popullit. Mbi bazën e tyre nga studiuesit Qemal Haxhihasani, Rrok Zojzi, Zini Sako, Ramadan Sokoli etj. u përgatitën studime, broshura, tekste mësimore që u shërbyen shkollave të vendit, ekspozita etj. Në vitin 1960 në veprimtarinë shkencore u përfshinë 225 studiues dhe pedagogë të Universitetit që punonin për rreth 300 tema.⁵⁴

Prof. Asoc. Dr. Enriketa KAMBO

BEGINNINGS OF SUPERIOR EDUCATION AND OPENING OF UNIVERSITY OF TIRANA (1946-1960)

Summary

With the end of World War Two initial measures were undertaken in Albania to advance superior education, representing the peak of the educational system pyramid. The process of establishing and consolidating of superior education went through two stages, when in the time sense that of changes and results, differ considerably from each other.

In the first stage that continued till the middle of 50s, the foundations of the superior school were laid. The 2-year Pedagogical Institute opened on 20th December 1946 marked the beginning of this educational category. In 1951 three new institutes were opened: High Pedagogical Institute (4 years), High Agriculture Institute and High Polly-Technical Institute. For the development of superior education many difficulties had to be overcome as everything was started from zero. None of the 17 first teachers had any university teaching

⁵³ Po aty, f.96-98.

⁵⁴ AQSH, Fondi 1011, viti 1958, dos. 53, fl.15-16.

experience. Original text-books in Albanian were scarce. In this period attention was paid rather to the extension of superior education and its strengthening.

The middle of 50s marked a very important moment in the process of crossing from the stage of setting the foundations of superior schools to the concentration of all activity in a directing and orientating center to cover the entire country. On 3rd of June 1957, the Presidium of People's Assembly issued a decree on one of the most important laws on education field, founding of the University of Tirana that opened its doors on 16th of September that year. The founding of the University was undoubtedly a result of the state's engagement and of efforts by all intellectual forces. They were fully aware that the well-being of the University meant serious obligation on preparing a new generation of intellectuals to serve future emancipation of the Albanian society.

